



Viti i XV-të i Botimit, Nr.2  
Dhjetor 2023

## TENTATIVA PËR RIMARRJEN E KORÇËS (PUÇI GREK I KORÇËS).

**Ndriçim Mehmeti\***

*\*Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Albanian University*

### Abstrakt

Ngjarjet prag fillimit të Luftës së Parë Botërore e gjejnë Shqipërinë me një status juridik të përcaktuar nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër, e cila u mbajt në vitet 1912-1913, por që vetëm në mars 1914, u bë e mundur ardhja e Princ Vidit në Durrës dhe formimin e qeverisë së re. Pavarësisht angazhimit të Fuqive të Mëdha të kohës, stabiliteti politik i Shqipërisë si dhe frenimi i oreksit të shteteve ballkanike, për të përfituar nga brishtësia e shtetit shqiptar, do të rezultojnë me vëzhgime të shumta në zbatimin e vendimeve të Konferencës së Londrës.

Punimi që po paraqesim, përpiqet të pasqyrojë situatën e Shqipërisë, pas ardhjes së Princ Vid-it në Shqipëri, vështirësitë me të cilat u paraqit qeverisja e tij si dhe tentativat e shteteve fqinje ballkanike, për të mos e lënë, Shqipërinë të mëkëmbet dhe gjithashtu për të përfituar territore në favor të tyre, si në rastin e Greqisë, të cilin po e paraqisim në këtë punim. Punimi synon që nën dritën e fakteve dëshmive të kohës, shtypit, etj, të nxjerr në pah situatën e vështirë në të cilën u ndodh popullata, mënyra e mbrojtjes së qytetit të Korçës dhe aktorët që u përfshinë në këtë ngjarje mjaft të rëndë.

Gjatë punës kërkimore me qëllim krijimin e një panorame të qartë të ngjarjeve, problematikave që ajo solli, si dhe ndikimi që pati në jetën e vendit tonë janë përdorur metodat cilësore si dhe një hulumtim grumbullues, përshkruar e analizues.

**Fajlet kyçe:** *Korçë, tentativa, Greqia, mitropolia, Shqipëria*

### Abstract

The events before the beginning of the First World War found Albania with a legal status determined by the Conference of Ambassadors in London, which was held in the years 1912-1913, but only in March 1914, the arrival of Prince Vidi in Enduring and the formation of the new government. Despite the commitment of the Great Powers of the time, the political stability of Albania as well as curbing the appetite of the Balkan states, to take advantage of the fragility of the Albanian state, would result in many difficulties in the implementation of the decisions of the London Conference.

The paper that we are presenting tries to reflect the situation of Albania, after the arrival of Prince Vid in Albania, the difficulties with which his governance was presented as well as the attempts of the neighboring Balkan states, not to let Albania succeed and also to gain territories in their favor, as in the case of Greece, which we are presenting in this paper. The paper aims to highlight the difficult situation in which

the population, the way of protecting the city of Korça and the actors who were involved in this rather serious event, in the light of the facts, the testimonies of the time, the press, etc. During the research work, in order to create a clear overview of the events, the problems it brought, as well as the impact it had on the life of our country, qualitative methods were used, as well as a collection, descriptive and analytical research.

**Key words:** *Korça, attempts, Greece, metropolis, Albania*

## TENTATIVA PËR RIMARRJEN E KORÇËS (PUÇI GREK I KORÇËS).

### Hyrje

Viti 1912, ishte një vit i rëndësishëm për shqiptarët dhe historinë e tyre që kulmuan me shpalljen e Pavarësinë së Shqipërisë, më 28 nëntor të atij moti. Njëkohësisht viti 1912, përkoj me humbjen e një sërë terriroresh të Perandorisë Osmane si dhe fillimin e luftimeve ballkanike. Serbia, Mali i Zi, Bullgaria e Greqia, shpjetuan të shfrytëzojnë dobësnimin e “të sëmurit të Bosforit”, për të përfituar zgjerim territorial në kurriz të tokave shqiptare. Deri në nëntor të vitit 1912, shqiptarët nuk u njihej asnjë e drejtë si kombësi, as autonomia dhe as mundësia për të pasur një shtet të pavaruar. Po ashtu Fuqitë e Mëdha ishin të dyzuara nga dëshira për të ruajtur paqen, por njëkohësisht për të siguruar sa më shumë mbështetje nga shtetet ballkanike, duke krijuar zoant e ndikimit të tyre. Rusia dhe Franca anonin nga Serbia, Greqia, Bullgaria dhe Mali i Zi, Anglia në dukje asnjajëse kishte një adhurim të veçantë për Greqinë, por edhe një mbështetje të heshtur për Serbinë, ndërsa Austro-Hungaria dhe Italia, pavarësisht rivalitetit të tyre, për ndikim në territoret shqipëtare, ishin të dënuara të bashkëpunonin për të mos lejuar Serbinë të kishte një dalje në Adriatik dhe njëkohësisht Greqia të mos ishte kërcënim për mbizotërimin e Italisë në Mesdhe. Këtyre dy shteteve, ju bashkangjit edhe Gjermania, e cila, kishte në krye të Shqipërisë, bashkëatdhtarin e vet, Princin Vilhelm von Vid. Tashmë ishin ravijëzoaur dy blloqet e Fuqive të Mëdha: Rusi, Francë Angli (Antanta) dhe Austro-Hungari, Itali e Gjermani (Blloku Qendror). Këta të fundit u përpoqën të mbanin në prehrin e tyre Shqipërinë e vogël e të dobët dhe ta mbronin nga pangopësia e fqinjëve ballkanik të përkrahur nga Antanta. Punimi që kemi zgjedhur, do të japi një aspekt të ambicjes së Greqisë, për përfitime terriroiale mdaj Shqipërisë. Pasi u detyrua të pranonte de jure kufijtë e Shqipërisë, de facto, Greqia nxiti të ashtuquajturat lëvizje “të brendshme” të popullsisë së “greke në të folur dhe ndërgjegje”, duke krijuar edhe një qeveria “autonome” të “Epirit të Veriut” dhe që kryesohej nga Jorgji Kristaq Zografi, një ortodos me origjinë nga Zagoria e Gjirokastrës, ish Ministër i Punëve të Jashtme të Greqisë dhe Deputet i Parlamentit grek, pas rebelimit në Shqipërinë e Jugut. Athina zyrtare mendonte se marrja e Korçës zemra e shqiptarisë në juglindje të vendit, do të hapte rrugën për një aneksim më të gjerë të tokave të jug të Shqipërisë, prandaj mendoj ta shtrinte aksionin e saj pikërisht në qytetin e Korçës.

### Puçi grek i Korçës

Përgatitjet për të futur Korçën nën autoritetin e qeverisë autonome, të krijuar nga K.J. Zografi, më 1914, ose për ta shkëputur atë nga Shqipëria, kishin kohë që kishin filluar. Mitropoliti grek i Durrësit, Gjermanos ishte bërë streha e komplotit që pritej të kurorëzohej. “Goditja e Korçës ishte përgatitur nga një prift sektar, fanatik, një komitaxhi i vërtetë.” (Skëndo. L, 1915) Në datën 1 dhe 2 prill u bënë përgatitjet e duhura që aksioni ushtarak të kishte sukses. Kjo do të ishte një mundësi e mirë për të tërhequr vëmendjen nga ngjarjet në territoret e tjera, të Shqipërisë, si dhe për të shtrirë autoritetin e qeverisë së Zografosit edhe në krahinën e Korçës. “Sulmi filloi të enjten në mëngjes, më 2 prill, në orën 2.30’ të mëngjesit. Natën e të mërkurës më 1 prill, zonja Dako kishte shkuar të thërriste një fqinj. Ndërsa ishte atje, djali i shtëpisë hyri brenda duke lajomëruar se kishte parë një numër andartësh të hynin në shtëpinë e dr.Polenës. Zonja Dako menjëherë shkoi të njoftonte majorin Shellen. U thirrën njëzet vullnetarë nga policia rezerviste dhe shtëpia e dr.Polenës u rrethua.” (Dako.K, 2003) Bandat epirote e kishin llogaritur që të gjenin të papërgatitur forcat shqiptare dhe sulmi i tyre të kishte sukses. Parashikimi i tyre nuk arriti të realizohej, ndonëse peshkopi Gjermanos, mendoj se gjithçka do të shkonte sipas planit. “Kapiteni” Sulo rreth mesnatës hyri në

qytet duke shkuar së pari në selinë e Peshkopit, dhe në orën 2 e gjysmë fshatarët hapën zjarr nga kodrat. Peshkopi pastaj nisi me dy sinjalizues të “Rregjimentit të shenjtë” urdhërin për thirrjen e Asamblesë. Në të njëjtën kohë urdhëroi t’u binin kambanave të tri kishave. ” (Dako.K, 2003) Goditja e parë shkaktoi panik në qytet dhe u shoqërua me reprazalje dhe frikë. “Në agim pamë nga dritaret tona të ecnin nëpër rrugë anadartë, ushtarë me uniforma të “Rregjimentit të shenjtë” dhe oficerin Papadakis. Gjithë lagjja e të krishterëve u urdhërua të ngrinte flamurin grek.” (Dako.K, 2003) Menjëherë forcat e komanduara nga majori Shellen u organizuan në mbrojtje të ndërtesave qeveritare. Dukej se tashmë do të luftohej rrugë më rrugë dhe ndërtesë më ndërtesë. Në këto luftime andartët dhe ushtarakët grekë nuk kursyen asnjë, përfshi këtu edhe majorin holandez dhe pjesëtarë të klerit ortodoks. “Grekët pushtuan ndërtesën e Bashkisë së qytetit, shkollat dhe kishat. Shqiptarët mbronin zyrën e qeverisë dhe stacionin e telegrafisë. Në përpjekje për të vajtur tek stacioni i policisë, majori Shellen u plagos prej një mësuesi grek nga Arta.”

(Dako.K, 2003) Ndonëse i plagosur majori Shellen arriti të organizoj forcat e pakta qeveritare në Korçë. Ndërkaq patriotët shqiptarë arritën që me shpejtësi të grumbullojnë forcat të shumta vullnetare për të çli-ruar qytetin e Korçës. Sulmi i datës 2 dhe 3 prill nuk arriti rezultatet e pritura. Për këtë qëllim autoritete greke vunë në mbështetje forcat e tyre të rregullta ushtarake. Pjesëmarjen e trupave të rregullta në krah të forcave autonomiste, Kondis e shpjegon kështu: “Në kundërshtim me udhëzimet e qeverisë greke, një numër i madh ushtarakësh grekë kaluan dhe u bashkuan me ushtrinë autonomiste. Edhe vullnetarë nga Kreta shumica me barka të vogla, gjetën rrugën për në Epirin e Veriut. Për oficerët komandues ishte e vështirë të ndalonin dezertimet dhe asgjë nuk mund ta ndalte mbështetjen e pavarur greke.” (Kondi. V., 2007)

Përveç oficerëve të lartë të ushtrisë greke, të cilët mbanin “gradat togerë e kolonelë”, Greqia aktivizoi edhe politikanë si ish-deputeti grek Bushios i Serfixhesë në parlamentin otoman. Jorgji Bushios jo vetëm që u caktua për organizimin e goditjes së dytë, por sipas Vllamasi ai “kryesonte një fuqi ushtarake”. (Vllamasi. S, Tiranë, 1995) Kjo goditje e dytë i gjeti shqiptarët më të organizuar dhe me forca më të shumta ushtarake. Majori Shellen mori masa të mira organizative që xhandarmëria ta përballonte me sukses sulmin.

“Xhandarmërisë shqiptare dhe korpusit të vullnetarëve iu bashkuan qindra fshatarë me në krye Th.Gërmenjin.” (Historia e Historia e Popullit Shqiptar, Tiranë, 2007). Me këtë riorganizim të ri forcat shqiptare u pozicionuan mirë brenda qytetit dhe në rrethinat e tij. “Forcat e Kajo Babienit u vendosën në vreshtat e Korçës, ku shpartalluan fuqitë e Jorgji Bushios. Nga ana tjetër fshatarët e Mborjes, në grykën e Mborjes çkatërruan fuqitë e doktor Harisiadhit (korçar), të përbërë prej 400 vetash. (Vllamasi. S, Tiranë, 1995) Brenda në qytet, majori Shellen i kishte grupuar forcat e tij në tri formacione: “Kapiteni Doorman , i misionit holandez, nisi sulmin nga lindja; kapiten Ghilardi nga jugu dhe zoti Spencer që kishte qenë oficer i marinës amerikane, nga perëndimi.” (Dako. K, Tiranë, 2003). Përveç këtyre masave, majori Shellen grupoi një pjesë të forcave të tij, për të rrethuar dhe neutralizuar veprimtarinë e mitropolitit grek Gjermanos. Besohej se në ndërtesën e mitropolitit mund të strehoheshin forca të armatosura. Edhe nëse nuk vërtetohet ky fakt, tashmë ishte e ditur që rebelimi e kishte qendrën tek Mitropoliti grek. “Zoti Spenser urdhëroi njerëzit e tij të shpërfillnin goditjet që vinin nga shtëpitë përreth dhe të sulmonin drejtëpërdrejtë tek selia e Peshkopit. Pas gjysmë ore mbërriti, kapiteni Doorman dhe kapiteni Ghilardi. Të tre komandantët e vunë në mes Peshkopin për ta mbrojtur dhe e çuan tek majori Shellen.” (Dako. K, 2003). Kondis ndalet shumë pak tek kjo ngjarje. Ai përshkruan vetëm në pak rreshta sulmin epirot mbi “xhandarmërinë shqiptare” (Kondis.V., 2007) dhe ndërhyrjen e majorit Shellen për mbrojtjen e qytetit Fitorja e dytë e forcave shqiptare, largoi njëherë e mirë rrezikun për pushtimin e qytetit. Për pothuaj pesë ditë me rradhë, xhandarmëria shqiptare e udhëhequr me maturi dhe guxim nga oficerët holandezë zbrapsi sulmin e forcave greke dhe neutralizoi çdo përpjekje për të marrë në dorë qeverisjen e qytetit. Përkrahja që popullata e qytetit dhe fshatrave përreth i dha mbrojtjes së Korçës ishte përgënjeshtrimi më mirë i pretendimeve se qyteti kishte natyrë dhe ndërgjegje greke. Shqiptarët në këtë rast treguan se ishin të gatshëm të mbronin me çdo çmim vendin e tyre, ndërsa Korça u konfirmua edhe njëherë si djep i nacionalizmit shqiptar. Nëse do të ishte e kundërta, do të kishte qenë krejt e pamundur që një grusht xhandarësh të mund të mbanin qytetin kundër dëshirës së vetë popullsisë. Ajo që mbeti gjatë në memorien e qytetarëve në pesë ditët e sulmit ishte ter-

rori që u ushtrua nga forcat greke. Vlen të përmendet mes shumë veprimeve të dhunshme, vrasja e priftit Papa Harallamb Bllamaqi të Korçës. “Grekët therrën me gjakftohtësi, priftin papa Harallambi të Korçës së bashku me vëllanë dhe kushëririn e tij.” (Skëndo.L., 1915) Ky veprim i shëmtuar i kryer ndaj një njeriu të fesë, që mesa duket nuk i ishte përshtatur politikës greke, shkaktoi indinjim të madh. Grekët që e panë se në këtë rast kishin tejkaluar çdo normë, nxituan t’i japin ngjarjes ngjyra më të buta.

Për të larguar përgjegjësinë e tyre, gazeta “To Kronos” (Koha), jep këtë version për situatën e krijuar. “Në rrethanat e krijuara mund të jetë vlarë ose plagosur rëndë at Harallambi.” Ky përgënjeshttrim i gazetës kërkon të largojë përgjegjësinë e autoriteteve greke dhe ta paraqesi ngjarjen si aksidentale. Ngjarja duket të ketë qenë e paramenduar. Me të drejtë Mit’hat Frashëri shkruan se: “Marrja e një prifti me zor nga shtëpia, nuk mund të quhet një plagosje e thjeshtë.” Përpjekja e shtypit grek për të hequr përgjegjësinë e Greqisë në këtë rast shkoi edhe më tej. Në një shkrim të gazetës “Koha” të datës 10 prill 1914, u bënë përpjekje që faji t’i hidhej shqiptarëve.

Duke ju referuar ngjarjeve të Korçës, mes të tjerash shkruan: “Xhandarmëria greke pasi ç’armatosi me paramendim popullsinë e Korçës, u hodh në masakra me karakter të përgjithshëm. Qeveria greke i bën të ditura këto fakte Fuqive të Mëdha.” (Skëndo.L., 1915) E gjithë kjo histori e stisur nga gazeta greke mund të përgënjeshtrohet fare mirë nga vetë burimet zyrtare greke. Duke përshkruar masat e marra nga autoritetet greke të pushtimit në Korçë, përpara evakuimit të qytetit, Kondis shkruan: “Duke u përgatitur për evakuimin e Korçës qeveria greke u dërgoi autoriteteve ushtarake atje këto udhëzime:

- a) Të ndalonin armatimin e popullsisë myslimane dhe të kthenin armët që kishin marrë;
- b) Të çarmatosnin çdo bandë të armatosur dhe t’i ndalonin të hynin në qytet” (Kondis. V., 2007)

Në dritën e këtyre fakteve lind pyetja: Pse xhandarmëria shqiptare do të ndërmerre një veprim të tillë, kur popullata ishte çarmatosur shumë kohë më parë (sipas pretendimeve të Greqisë, pranë Fuqive të Mëdha)? Nga ana tjetër në raportet e majorit Shellen dërguar Esat Pashë Toptanit dhe kolonelit Tomson, nuk ka asnjë shqetësim për një revoltë të brendshme të popullsisë. Vetëm në këtë rast mund të ishin të justifikueshme masat e sipërpërmendura nga shtypi grek, për xhandarmërinë shqiptare. Përkundrazi rrjedha e ngjarjeve të Korçës tregonte se, njerëzit e armatosur ishin bandat epirote. Këto forca nuk kursyen as vetë majorin Shellen, të cilin ndoshta fati i shpëtoi jetën. Duhet të ishte qeveria shqiptare ajo që duhej të akuzonte drejtëpërdrejtë Greqinë për veprimtari që binin në kundërshtim të hapur me vendimet e Fuqive të Mëdha. Greqia duhet të shpjegonte sesi ishte e mundur që ajo nuk frenonte dot “dezertimin” e ushtarakëve të saj dhe bashkimin me forcat autonomiste. Sulmi i 6 prillit të vitit 1914, ishte tërësisht i organizuar dhe udhëhequr nga ushtria greke. “Ushtarët të kapur më 6 prill 1914 pohuan se ishin ushtarë grekë duke dhënë numrin e kompanisë dhe batalionit të tyre.” (Skëndo.L., 1915)

Forcat autonomiste në sulmin e tyre nuk respektuan asnjë rregull që qoftë edhe në një luftë normale, janë të detyrueshme për tu zbatuar. Sulmi i bandave nuk kurseu në këtë rast shkollën amerikane. “Ndonëse z.Spencer ngriti flamurin amerikan në ndërtesën e shkollës, ajo u sulmua disa herë.” (Dako.K., 2003) Në lidhje me vrasjen e at Bllamacit, disa vjet më vonë në një reportazh të gazetarit rumun dr.Vlad Vantenau, për gazetën “Cuvantul” mes të tjerash shkruan: “Ata (grekët) vrisnin dhe shkatërronin, digjin katunde dhe qytete, kishin për qëllim të zhduknin nga Shqipëria e Jugut elementin shqiptar dhe arumun, që në këtë mënyrë më vonë të mundnin të proklamnin Jugun si vend të banuar prej grekësh. Një njeri me kompetencë arumun nga elita e Korçës z.Bllamaqi që rrjedh nga një familje e nderuar kreshnike arumune e cila u shkatërrua prej grekëve tregon për masakrat.” (“Shqip”, 2006). Forcat shqiptare jo vetëm që nuk kryen terror ndaj popullsisë por e shpëtuan këtë të fundit nga terrori. Sjellja e xhandarmërisë shqiptare ishte e një shkalle të lartë profesionalizmi. Në çdo vend tjetër në një rast të ngjashëm masat do të ishin shumë të ashpra. Në fakt ndodhi krejt e kundërta. Majori Shellen në rastin e arrestimit të Mitropolitit grek, Gjermanos, e çoi këtë të fundit në Elbasan për arsye sigurie. Qeveria shqiptare nuk zhvilloi asnjëherë hetime dhe nuk mori asnjë masë, që në raste të tilla ishin mëse të justifikueshme.

E gjithë kjo u bë jo në emër të dobësisë së autoriteteve vendase por në emër të një jete normale pa paragjykime. Kjo mënyrë të vepruari do të ishte shumë efektive nëse edhe qeveria shqiptare do të ishte

treguar më e vendosur në trajtimin e çështjes së Shqipërisë së Jugut.

### Referencë:

1. Skëndo.L., “L’Affaiers del Epir” Sofje, 1915, fq.23.
2. Dako.K, “Shqipëria çelësi i Lindjes së Afërme”, Tiranë, 2003. faqe166
3. Kondi.V. “Greqia dhe Shqipëria” ,Tiranë 2007., fq.174-175.
4. Vllamasi. S, “Ballafaqime politike në Shqipëri”, Tiranë, 1995, fq.72
5. Historia e Historia e Popullit Shqiptar” (28 Nëntor 1912-7 Prill 1939), Vëll.III, Bot. i Akademisë së Shkencave,Tiranë 2007, fq. 72-73.
6. Gazeta “Shqip”, suplementi “Ndryshe”, 24 shtator 2006, fq. 26-27